



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS  
DREJTORIA E BURIMEVE NJEREZORE, SHERBIMEVE DHE  
DOKUMENTACIONIT**

**Njoftim per vend te lire pune**

**Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Integritit**

Në zbatim të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", neni 13/3, VKM nr. 231, datë 11.5.2000 "Për pranimin në shërbimin civil dhe periudhën e provës", pika 7, ndryshuar me VKM nr. 196, datë 6.4.2001, pika 1, Autoriteti i Konkurrencës shpall konkursin për një vend të lirë pune në pozicionin, *Drejtor i Drejtorisë Juridike dhe Integritit*.

Kandidati duhet të plotësojë **kërkesat e përgjithshme** në përputhje me nenin 12 të ligjit nr.8549 dt.11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

**Kërkesa të veçanta për kandidatin:**

- Të jetë diplomuar në Fakultetin e Drejtësisë me note mesatare mbi 8
- Preferohet kualifikim pasuniversitar,
- Të ketë të pakten 5 vjet pune në administratën publike.
- Të zotërojë aftësi të mira drejtuese, menaxhuese, raportuese
- Të zotërojë gjuhën angleze, një gjuhë e dytë e Komunitetit European përbën avantazh.
- Të ketë aftësi të mira organizuese, komunikuese dhe të punës në grup.
- Të përdorë programet bazë të kompjuterit

**Kandidati do të pëgjigjet për:**

Zbatimi dhe persosja e legjislacionit të së drejtës së konkurrencës.

Vlerësimi dhe përmirësimi i përputhshmërisë së projektave normative të propozuara nga Institucionet e tjera qendrore dhe vendore lidhur me ligjin 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës" si dhe me *acquis Communautaire*.

Pershtatja dhe parafrimi i legjislacionit me ato të BE

**Paraqitja e dokumentave**

Kandidati duhet të paraqesë brenda datës **01.07.2007** në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, Shërbimeve dhe Dokumentacionit pranë Autoritetit të Konkurrencës, në adresën: Rruga Sami Frashri nr.4, kati IV; këto dokumenta:

- Kërkesën për aplikim.
- Curriculum Vitae
- Çertifikatë personale me foto dhe përbërje familjare.
- Fotokopje të diplomës dhe listës së notave të noterizuara.
- Çertifikata kualifikimi (në rast se ka).
- Vlerësim pune nga punëdhënësi i fundit.

- Fotokopje të librezës së punës dhe librezës së kontributeve.
- Dëshmi e gjendjes gjyqësore dhe mjeksore.
- Dokumenti për master, doktoraturë (në rast se ka), fotokopje e noterizuar
- Dëshmi e gjuhës së huaj ose certifikate e vlefshme me të.

Studentët që kanë kryer studimet jashtë shtetit duhet të kenë bërë **njohjen** e diplomave apo certifikatave.

Dokumentet duhen të paraqiten vetëm në gjuhën shqipe.

**Konkurimi:** Është i hapur për nëpunësit civil të të njëjtës klasë me procedurat e lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë si dhe për kandidatët jashtë administratës publike sipas procedurave të pranimit në shërbimin civil.

Pas verifikimit paraprak të dokumentave në datën 04.07.07, në zyrat e Autoritetit të Konkurrencës do të shpallet lista e konkurrenteve që do të vazhdojnë më tej konkurimin si dhe data kur do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista me gojë.

***Fushat e testimit:***

Konkurimi do të bazohet në njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 " Për Mbrojtjen e Konkurrencës" dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij, njohuri mbi Politikën Kombëtare të Konkurrencës, mbi legjislacionin Europian në Fushën e Konkurrencës, njohuritë për Kushtetutën, Kodin e Procedurave Administrative, Kodi i Procedurës Penale ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil", ligjin nr. 9131 datë 8.9.2003 "Për rregullat e etikës në administratën publike".

***Materialet mund ti gjeni në: [www.caa.gov.al](http://www.caa.gov.al)***